



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

APS.nr.1/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti Special, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Kreshnik Radoniqi – Kryetari i kolegjit, Vaton Durguti dhe Milan Bigovic – anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bajram Rexhahmetaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit F.M. për shkak të veprës penale *Shtytja për kryerjen e veprave penale terroriste* nga nenin 134 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit e të akuzuarit F.M., avokat Blerim Çela, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, PS.nr.54/20 të datës 18.12.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPRK-së, më datë 10.02.2021 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit F.M., avokat Blerim Çela, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, PS.nr.54/20 i datës 18.12.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, PS.nr.54/20 i datës 18.12.2020 i akuzuari F.M. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale *Shtytja për kryerjen e veprave penale terroriste* nga nenin 134 të KPRK-së, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënimi do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 20.10.2020 e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, por jo më gjatë se dënimi i shqiptuar. Është obliguar që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë paushallin gjyqësor në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit. I dëmtuari Q.G. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civilo-juridik.

Në afat ligjor ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit F.M., avokat Blerim Çela, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin me propozim që Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen ti kthej gjykatës themelore në rigjykim apo eventualisht ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar në dobi të mbrojturit të tij dha atë të dënoj me dënim më të butë.

Prokuroria e Apelit të Kosovës në Prishtinë me shkresën PPA/I.nr.45/21 të datës 27.01.2021, ka propozuar që të refuzohet ankesa e mbrojtësit e të akuzuarit F.M., avokat Blerim Çela të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special PS.nr.54/20 të datës 18.12.2020, dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit, konform nenit 390 par.1 të KPPK-së, mbajti seancën publike të kolegjit më datë 10.02.2021 në të cilën morën pjesë i akuzuari F.M. me mbrojtësin e tij avokat Blerim Çela, ndërsa nuk prezantuan askush nga Prokuroria e Apelit e as i dëmtuari edhe pse të njoftuar në mënyrë të rregullt për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës. Mbrojtësi i të akuzuarit mbeti në tërësi pranë pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesë, ndërsa i akuzuari potencoi se nuk ka qenë i njoftuar me aktakuzën deri në momentin kur ka shkuar për gjykim dhe nuk ka pasur njohuri për veprën penale për të cilën akuzohet, dhe ka kërkuar që çështja të kthehet në rivendosje.

Gjykata e Apelit, analizoi shkresat e lëndës së bashku me aktgjykimin e ankimuar, të cilat i vlerësoi konform dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPRK-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve të theksuar në ankesë, gjeti se **ankesa është e pabazuar**.

Pretendimet ankimore

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit F.M., avokat Blerim Çela, pretendon se gjykata e shkallë së parë ka bërë shpërputhje me dispozitën ligjore të paraparë në nenin 385 par.1 nënpar.1.2 të KPPRK-së, me ç'rast në situatën konkrete janë dëshmuar dhe plotësuar të gjitha rrethanat që përjashtojnë përgjegjësinë penale ndaj të mbrojturit të tij, pavarësisht faktit se i mbrojturi i tij ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është ngarkuar nga prokuroria. I mbrojturi i tij nuk e ka ditur se vepra për të cilën është shpallur fajtor është e ndaluar, e po ashtu edhe gjatë seancës fillestare e ka kuptuar gabimisht procedurën e pranimit të fajësisë duke menduar se do ti jepet mundësia edhe në seancat tjera të deklarohet edhe të sqaroj se nuk e ka ditur që ky veprim është i paraparë si vepër penale, andaj në këtë rast kemi të bëjmë me lajthimin juridik të paraparë në nenin 26 të KPRK-së, e që lajthimi juridik është bazë për përjashtimin e përgjegjësisë penale. Më tej shton se nëse është fjala për ndonjë vepër e cila nga ana e shoqërisë dhe moralit të saj në masë të theksuar nuk dënohet, ashtu siç është rasti me veprën penale “Shtytja për kryerjen e veprave terroriste nga neni 134 të KPRK-së, për të cilën është akuzuari i mbrojturi i tij i cili veprim shumë lehtë mund të ngatërrohet me lirin e shprehjes së mendimit, pa pasur ndonjë qëllim tjetër, megjithatë për shkak të interesit individual dhe të përgjithshëm me normat juridike është përcaktuar si vepër penale, atëherë mund të konsiderohet se i mbrojturi i tij në këtë rast ka qenë në lajthim juridik të pa mënjanuar dhe merret si bazë për përjashtimin e përgjegjësisë penale. I mbrojturi i tij fare nuk e ka ditur se veprimi i tillë është vepër penale, por ai vetëm e ka shprehur mendimin e tij në rrjetin social “facebook” lidhur me veprimin e të dëmtuarit Q.G., pa pasur ndonjë qëllim që të shtytë dikë të kryej vepër terroriste dhe fare nuk ka mundur të dijë që një veprim i tillë përkatësisht shprehja e mendimit në këtë mënyrë paraqet vepër penale. Duke marrë parasysh faktin se i mbrojturi i tij është me profesion taksist, fare nuk ka mundur të dijë se një veprim i

tillë është veprë penale. Lidhur me sanksionin penal mbrojtja pretendon se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të nenit 387 të KPPRK-së, për arsye se nuk ka zbatuar dispozitat e zbutjes së dënimit sipas neni 71 par.1 nënpar.1.3 dhe 72 par.1 nënpar.1.5 të KPPRK-së, pasi që i mbrojturi i tij qysh në shqyrtimin fillestar ka pranuar fajësinë, po ashtu edhe nëse do të kishte marrë si bazë përjashtimin e përgjegjësisë penale, lajthimin juridik të pamënjanueshëm, atëherë së paku do të duhej t'ia kishte marrë parasysh si rrethanë lehtësuese për zbutjen e dënimit si në nenin 28 par.2 të KPPRK-së. Gjykata fare nuk ka marrë parasysh asnjërinë rrethanë lehtësuese gjatë matjes së dënimit. Po ashtu marrë parasysh nenin 49 par. 1 të KPPRK-së, gjykata ka pasur mundësi të shqiptoj edhe dënimin me kusht, pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë, ka shprehur keqardhje dhe pendim, veprën e ka kryer nga mosdija dhe pamaturia duke mos pasur asnjë qëllim për ti shkaktuar ndonjë dëm tani të dëmtuarit Q.G..

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, kjo gjykatë i vlerësoi sipas detyrës zyrtare, dhe gjeti se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të parashikuara në dispozitën e nenit 384 të KPPRK-së, apo shkelje tjera të cilët kishin me kushtëzua anulimin e aktgjykimit.

Gjykata e Apelit vlerëson të pabazuar pretendimin ankimor për shkeljen e ligjit penal ku mbrojtja pretendon se i akuzuari nuk ka ditur se vepra penale për të cilën është shpallur fajtor është e ndaluar dhe gjatë seancës së shqyrtimit fillestar e ka kuptuar gabimisht procedurën e pranimit të fajësisë, duke u gjetur në lajthim juridik dhe se nuk ka qenë i njoftuar me aktakuzën deri në momentin kur ka shkuar për gjykim.

Nga shkresat e lëndës rezulton se mbrojtësi i të akuzuarit avokati Blerim Çela ka pranuar aktakuzën me datë 11.12.2020 ku i njëjti ka nënshkruar fletë-dërgesën, ndërsa nga procesverbali i shqyrtimit fillestar i datës 16.12.2020, rezulton se prokurori ka përmbushur detyrimin për zbulimin e provave, ku edhe mbrojtja pohon se ka pranuar materialin me kohë nga Prokuroria. Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i shtetit, i pandehuri ka deklaruar se akuzën e ka kuptuar dhe nuk ka nevojë për sqarime shtesë dhe lidhur me deklarin për fajësinë i akuzuari është deklaruar se: *“populli thotë që faji është jetim andaj nuk e merr askush tash po e citoj një thënie të profetit Muhamet a.s i cili ka thënë se ai i cili kujdeset për jetimin do të jetë me mua në xhenet. Andaj në bazë të kësaj unë F.M. e pranoj fajësinë plotësisht dhe deklarohej fajtor për këtë punë dhe shpresoj te Zoti që nesër do të jem në xhenet”*. Në pyetjen sqaruese të kryetarit të trupit gjykues i akuzuari është deklaruar: *“po e pranoj fajësinë”* ndërsa mbrojtësi i të akuzuarit avokati Blerim Çela ka mbështetur në tërësi pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij duke shtuar se jemi konsultuar mjaftueshëm dhe i njëjti ka kuptuar benefitet dhe pasojat që rrjedhin nga pranimi i fajësisë, pasi që i njëjti që në fazën fillestare ka pranuar kryerjen e kësaj veprë penale.

Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se i akuzuari pas leximit të akuzës nga Prokurori në shqyrtim fillestar por edhe në konsultim me mbrojtësin e tij ka pasur të qartë se për çfarë akuzohet nga prokuroria dhe në konsultim me mbrojtësin e tij ka pranuar në mënyrë vullnetare fajësinë dhe kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar andaj, nga kjo rezulton në mënyrë të qartë se i akuzuari ishte në dijeni të plotë dhe të qartë lidhur me atë se për çfarë po akuzohet nga prokuroria dhe se në asnjë rrethanë nuk ka mundur që të gjendet në lajthim juridik rreth procedurës së pranimit të fajësisë pasi që i akuzuari ishte konsultuar me mbrojtësin e tij rreth pranimit të fajësisë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

Po ashtu pretendimi ankimor se, i akuzuari nuk ka ditur se veprimi i tillë është vepër penale, por ai vetëm e ka shprehur mendimin e tij në rrjetin social, kolegji penale i kësaj gjykate e gjen si të pabazuar për faktin se nga vet përmbajtja e tekstit “*shkurt e shqip duhet të vritet Q.G.*” dhe “*ka si ti ende do vritet dhe ky qeni Q.G.*”, nuk mund të kuptohet thjesht si një shprehje e mendimit të lirë por si thirrje për të vrarë të dëmtuarin dhe të tjerë dhe kjo thirrje publike me këtë përmbajtje nëpërmjet rrjetit social nga i akuzuari paraqesin veprim inkriminues për të cilin i akuzuari ka pranuar në tersi këtë vepër penale, prandaj duke qenë se i akuzuari ishte i vetëdijshëm për veprimet e veta dhe penalisht përgjegjës në kohën e kryerjes së veprës penale të mos jetë gjetur as në situatën e lajthimit juridik, andaj nga këto arsye kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka aplikuar drejtë ligjin penal në këtë çështje penalo-juridike dhe nuk rezulton se kemi të bëjmë me shkeljen e ligjit penal ashtu si pretendon mbrojtja në ankesën e saj.

Gjykata e Apelit gjen të pabazuar pretendimin ankimore se gjykata nuk ka zbatuar dispozitat për zbutjen e dënimit dhe nuk ka marrë parasysh pranimin e fajësisë për zbutjen e dënimit duke pretenduar se gjykata e shkallës së parë ka pasur mundësi që të akuzuarit ti shqiptoj dënim me kusht. Në anën tjetër mbrojtja në ankesë nuk theksohet ndonjë rrethanë konkrete të cilën gjykata e shkallës së parë nuk e ka marrë parasysh gjatë matjes të llojit dhe lartësisë së dënimit.

Gjykata e Apelit rikujton se gjatë shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit në një rast konkretë penal gjykata vlerëson rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit por jo detyrimisht, kur pranohet fajësia e të akuzuarit, duhet të zbatohet dispozitat e zbutjes së dënimit apo shqiptimit të dënimit alternativ ngase kjo është një mundësi ligjore që gjykata vlerëson në secilën rast konkretë nëse kjo rrethanë kishte për të mbi peshuar në raport me rrethanat tjera dhe kishte për të ndikuar në aplikimin e zbutjes së dënimit nën minimumin e paraparë ligjor apo shqiptimin e dënimit alternativ.

Gjykata e shkallës së parë gjatë caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ka pasur parasysh rrethanat nga neni 69 të KPRK-së, ku si rrethanë veçanërisht lehtësuese mori pranimin e fajësisë, sjelljen e të akuzuarit në gjykatore, pendimin e thellë, gjendjen e dobët ekonomike ndërsa si rrethanë rënduese ka gjetur sjelljen e tij të mëparshme sepse i pandehuri ndiqet penalisht për disa vepra penale, por që konkretisht është i dënuar me aktgjykim të formës së prerë P.nr.992/19 për veprën penale, Vetëgjyqësia nga neni 418 par.1 të KPRK-së, e rrethana këto që tregojnë për gjykatën karakteristikat e tij personale.

Në përjashtim të rrethanës rënduese që i pandehuri ndiqet penalisht për disa vepra penale, Gjykata e Apelit, i aprovon gjetjet e Gjykatës së shkallës së parë përkitazi me rrethanat për caktimin e dënimit dhe vlerëson se dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale e të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, motivin për kryerjen e veprës penale dhe sjelljen e mëparshme e të akuzuarit duke qenë e bindur se dënimi i shqiptuar do të shërbej për arritjen e qëllimit të parandalimit të kryerësit nga kryerja e vepra penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij por njëkohësisht të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqërorë për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektim të ligjit, në përputhje me nenin 38 të KPPRK-së.

Gjykata e Apelit konstaton se gjykata e shkallë së parë gabimisht ka vlerësuar si rrethanë rënduese se i pandehuri *ndiqet penalisht për disa vepra penale*, e që sipas gjykatës së shkallës së parë kjo tregon karakteristikat e tij personale (sjellja e mëparshme e kryerësit), ngase kjo është rrethanë e përgjithshme për caktimin e dënimit dhe nuk mund të merret si rrethanë rënduese për matjen e dënimit e që është ndryshe me rrethanën, ku me të drejtë gjykata e shkallë së parë ka vlerësuar si rrethanë rënduese, në kuptim të nenit 70 par.2 pika 2.13 të KPPRK-së, dënimin penale të mëparshëm e të dënuarit, të cekur, si më lartë.

Nga arsyet e lartcekura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 401 të KPPRK-së.

GJYKATA E APELIT NË KOSOVË
DEPARTAMENTI SPECIAL
APS.nr.1/21 më datë 10.02.2021

Bashkëpunëtori Profesional

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit

Bajram Rexhahmetaj

Vaton Durguti

Kreshnik Radoniqi

Milan Bigovic